



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:039909
Datë: 08.05.2024
Numri i dokumentit: 05662221

C.2022:039910

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Kreshnike Zymberi - Beqiri, me bashkëpunëtorin profesional Gent Mustafa, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit M.G.me vendbanim në, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Lavdrim Xheladini nga Ferizaj, të paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” SH.A me seli në Prishtinë, në seancën përgatitore me datën 18 mars 2024 mori dhe përpiloi me shkrim këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET E TËRHEQUR - padia e paditësit M.G., të paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” SH.A, me objekt kontesti kompensim dëmi.
- II. DETYROHET – paditësi që në emër të taksës gjyqësore për parashtrimin e padisë të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzetë euro) dhe këtë ta bëj brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi M. G. të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Lavdrim Xheladini, me datën 28.02.2022 pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” SH.A me objekt kontesti kompensim dëmi.

Gjykata me datën 18.03.2024, ka caktuar seancën përgatitore ku ka ftuar të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse mirëpo në këtë seancë i autorizuari i paditësit nuk është paraqitur në seancë

përkundër faktit se nga flete kthesa vërtetohet i njëjti ftesën e ka pranuar me datën 01.02.2024, kurse nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për shtyrje të seancës dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

Meqenëse, i autorizuari i palës paditëse dhe i autorizuari i palës së paditur kanë munguar, Gjykata vlerësoi se janë përmbushur kushtet ligjore që propozimin e tij ta konsideroj të tërhequr sipas nenit 409 i LPK-së: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.”*

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, në pikën e II të dispozitivit të këtij aktvendimi e detyroi palën paditëse që të paguaj taksën gjyqësore, meqenëse edhe përkundër vërejtjes për taksë, paditësi nuk e ka paguar të njëjtën, andaj vendosi konform nenit 450 të LPK-së.

Andaj, bazuar në të lartcekurat në nenin 409 dhe 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.2022:039910, me datë 18 mars 2024

Gjyqtarja

Kreshnike Zymberi Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate